



AUTORITETI I KONKURRENCËS

RAPORTI VJETOR 2022

Prioritetet e Institucionit për vitin 2023

Përmbledhje Ekzekutive



PËRMBAJTJA

- 04 30" PËR T'U NJOHUR ME
AUTORITETIN
- 06 STATISTIKA
- 08 LEGJISLACIONI SEKONDAR
- 09 TREGJET E MONITORUARA
- 11 PROCEDURAT HETIMORE
- 16 PËRQENDRIMET
- 17 AK PËRBALLË PROCESEVE
GJYQËSORE
- 18 TË DREJTAT EKSKLUZIVE
- 19 BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR
- 20 INTEGRIMI EVROPIAN
- 21 KAPACITETE NJERËZORE
- 22 PRIORITETET 2022
- 24 STRUKTURA E AUTORITETIT

MISIONI

Hetimi i sjelljeve antikonkurruese

Kontrolli i përqendrimeve

Vlerësimi i të drejtave ekskluzive

Advokacia e kulturës së konkurrencës

30''

STATUSI *Institucion*

Publik i

Pavarur

5 Komisionerë

41 Punonjës

57

Ditë trajnimi
për punonjësit

31 janar 2022

KK vendosi për hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes VODAFONE ALBANIA SHA në tregun e shërbimeve celulare: tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare.

15 shkurt 2022

KK vendosi për hapjen e hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes NOA CONTROL SHPK, në tregun e ofrimit të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe GLN.

25 shkurt 2022

KK vendosi për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e tregtimit me shumicë të karburantit naftë dhe benzinë.

18 maj 2022

Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë për vlerësimin e veprimtarisë së AK për vitin 2021.

10 qershor 2022

KK miratoi "Udhëzim mbi kufizimet e konkurrencës "sipas objektit" për qëllime të përcaktimit të marrëveshjeve me rëndësi të vogël".

24 qershor 2022

KK vendosi për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes VODAFONE ALBANIA SHA në tregun e shërbimeve celulare: tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare.

27 dhjetor 2022

KK vendosi për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit, transmetimit dhe shitjes në mënyrë digjitale të produkteve audio dhe video, tek operatorët kabllor (ripërsëritësit e programeve mbështetur në rrjet kabllor), ndaj ndërmarrjes DIGITALB SHA.

për t'u njohur me

VEPRIMTARINË E AUTORITETIT

për vitin 2022

TË ARDHURA

26.110

milionë Lekë


Të ardhura të realizuara nga autorizimi i përqendrimeve

BUXHETI


74.624

milionë Lekë

Buxheti për vitin 2022




Numri i vendimeve në vite




Procedura hetimore në vite






Vendime të marra gjatë vitit 2022



Autorizimet e përqendrimeve



Tregjet e monitoruara gjatë vitit 2022

Legjislacioni sekondar

AKTE TË MIRATUARA NË KUADËR TË ZBATIMIT TË PKIE 2021-2023

Procesi i integritit evropian përbën një nga prioritetet e veprimtarisë së AK. Si një institucion lider dhe koordinator për kapitullin e tetë, “Politika e konkurrencës”, AK jep kontributin e tij në kuadër të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE), raporton në mënyrë periodike pranë Kryenegociatorit, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, për “Tregun e brendshëm dhe konkurrencën”, si dhe jep kontributin e tij për Progres Raportin.


Gjatë vitit 2022, AK ka hartuar Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2023 - 2025, i cili është dokumenti bazë për përcaktimin e prioritetëve, planifikimin, koordinimin dhe monitorimin e përmbushjes së detyrimeve në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. AK ka përgatitur dhe integruar në këtë plan kombëtar kapitullin 8 “Politika e konkurrencës”, duke parashikuar nismat ligjore afatshkurtra dhe afatmesme në kuadër të procesit të përafrimit të legjislacionit me atë të BE-së.

Në përputhje me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2021 - 2023, Autoriteti i Konkurrencës ka përmbushur 100% këtë plan, duke miratuar brenda afateve kohore të përcaktuara, nismat ligjore të parashikuara, në përputhje të plotë me legjislacionin evropian në fushën e konkurrencës.

Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 890, datë 10.06.2022, miratoi “Udhëzim mbi kufizimet e konkurrencës “sipas objektit” për qëllime të përcaktimit të marrëveshjeve me rëndësi të vogël”. Ky udhëzim u miratua brenda afateve të PKIE.

Qëllimi i Udhëzimit lidhur me marrëveshjet me rëndësi të vogël” (Rregullorja “de Minimis”) është ofrimi i siguri për ato lloj marrëveshjesh ndërmjet ndërmarrjeve, për të cilat Autoriteti i Konkurrencës (AK) vlerëson se nuk sjellin efekte mbi konkurrencën në treg. Sqaron kufizimet “sipas objektit” në marrëveshjet midis jo-kokurentëve, të cilat mund të dallohen në rastet kur ato lidhen me ndarjen e tregut sipas territorit dhe/ose grupit të klientëve ose me kufizimet në aftësinë e blerësit për të përcaktuar çmimin e rishitjes.

Përcaktimin e tre kufizimeve klasike "sipas objektit" në marrëveshjet midis konkurrentëve janë fiksimi i çmimeve, kufizimi i prodhimit dhe ndarja e tregut.



Tregjet e monitoruara

Autoriteti i Konkurrencës, në zbatim të nenit 28 të ligjit nr. 9121/2003, realizon monitorime dhe analiza të tregjeve, me qëllim zhvillimin e konkurrencës së lirë dhe efektive.

Gjatë vitit 2022, Autoriteti Konkurrencës monitoroi, dhe analizojë tregje të cilat kanë një impakt të drejtpërdrejtë në interesat e konsumatorit shqiptar, por edhe tregje të reja, në funksion të dinamikës së zhvillimit të tyre, sjelljes së ndërmarrjeve që operojnë në këto tregje, nevojave të konsumatorëve, si dhe elemente të tjera, të cilat lidhen me barrierat ligjore dhe ekonomike për hyrjen në tregje të operatorëve të rinj.



Sektori i arsimit të lartë



Tregu i importit të grurit; importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit



Tregu i prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto




Tregu i sigurimeve për produktin Kartoni Jeshil

Tregjet e monitoruara

Tregu i veprimtarive ekonomike që zhvillohen nga Federata Shqiptare e Futbollit



Tregu me pakicë i shërbimeve celulare



Tregu i sigurimeve për produktin TPL



Tregu i shitjes me shumicë dhe me pakicë i materialeve paramjekësore



Procedura hetimore

Tregu i importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike dhe inputeve bujqësore

Komisioni i Konkurrencës me anë të vendimit nr. 806, datë 04.06.2021, vitin e shkuar, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike DAP, nitrat dhe ure`, ndaj ndërmarrjeve: ARLI INTERNACIONAL SHPK, AGRO BLEND SHPK, MBM SHPK, ECO - GREEN SHPK, LILA SHPK, AGRO - MENS SHPK, ÇAÇA SHPK, IAM SHPK, AGROHELP - SA SHPK, dhe BESNIKU SHPK, për periudhën kohore nga 1 janari 2020 deri 30 shtator 2021.

Nga analiza e evidencave indirekte në lidhje me sjelljen e ndërmarrjeve, siç janë rritja e treguesve të përqendrimit, rritja e njëkohshme dhe në mënyrë të menjëhershme e çmimit të shitjes me shumicë, në kohën kur ndërmarrjet kanë patur gjendje të produktit nga periudha paraardhëse, e cila duhet të refleктоhej tek çmimi i shitjes me shumicë, konkludojmë se ndërmarrjet kanë koordinuar sjelljen, gjë që bie në kundërshtim me nenin 4 pika 1, germa a) dhe c), të ligjit nr. 9121/2003, duke përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë çmimet e shitjes dhe duke ndarë tregjet.

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 39 të ligjit nr. 9121/2003, më datë 17.03.2022 dhe 23.03.2022, zhvilloi seanca dëgjimore me përfaqësues të ndërmarrjeve AGRO BLEND SHPK, MBM SHPK, ÇAÇA SHPK, si dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Komisioni i Konkurrencës me anë të vendimit nr. 874, më datë 25.03.2022 vendosi:

1. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike DAP, nitrat dhe ure`, ndaj ndërmarrjeve: ARLI INTERNACIONAL SHPK, AGRO BLEND SHPK, MBM SHPK, ECO - GREEN SHPK, LILA SHPK, AGRO - MENS SHPK, ÇAÇA SHPK, IAM SHPK, AGROHELP - SA SHPK dhe BESNIKU SHPK.
2. Monitorimin e tregut të importit dhe shitjes me shumicë të plehrave kimike DAP, nitrat dhe ure`, për një periudhë 1 (një) vjeçare nga data e daljes së këtij vendimi.
3. Gjeditjen e ndërmarrjes AGRO BLEND SHPK në shumën 118,978,015 lekë, për shkelje të nenit 4, pika 1, gerrat a) dhe c), të ligjit nr. 9121/2003. Gjeditjen e ndërmarrjes MBM SHPK në shumën 66,088,573 lekë, për shkelje të nenit 4, pika 1, gerrat a) dhe c), të ligjit nr. 9121/2003. Gjeditjen e ndërmarrjes ÇAÇA SHPK në shumën 7,087,994 lekë, për shkelje të nenit 4, pika 1, gerrat a) dhe c), të ligjit nr. 9121/2003.



Procedura hetimore

Tregu i ofrimit të shërbimit të instrumenteve matëse nëpërmjet instrumenteve shpërndarëse të karburanteve dhe gazit të lëngshëm

KK me vendimin nr. 884, datë 18.05.2022 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes NOA CONTROL SHPK në tregun e ofrimit të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm, me detyrime për ndërmarrjen NOA CONTROL SHPK dhe rekomandime për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë” vendosi:

- Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes NOA CONTROL SHPK, në
1. tregun e ofrimit të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe GLN-së;
 2. Detyrimin e ndërmarrjes NOA CONTROL SHPK, si një ndërmarrje me të drejta të veçanta nëpërmjet Kontratës së koncesionit “Për shërbimin e kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm”, që gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj të respektojë parimet dhe rregullat e konkurrencës, veçanërisht parashikimet e nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar.
 3. T’i rekomandojë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si vijon:
 - a. Miratimin e një metodologjie për llogaritjen e ndryshimit të tarifave të shërbimeve të ofruara nga Shoqëria Koncesionare NOA INSPECT SHPK, tarifa këto të cilat duhet të jenë të argumentuara dhe të orientuara drejt kostos;
 - b. Në çdo rast të ndryshimit të tarifave të ofrimit të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm dhe çdo shërbimi tjetër të ofruara nga Shoqëria Koncesionare NOA INSPECT SHPK, të merret paraprakisht vlerësimi ligjor i Autoritetit të Konkurrencës;
 - c. Në çdo rast të ndryshimit të tarifave të ofrimit të shërbimit të kontrollit ligjor të verifikuar që rezultojnë me probleme, duke implementuar rekomandimin e dhënë nga Komisioni i Konkurrencës ex ante me vendimin nr. 646/2019, “Për dhënien e disa rekomandimeve në lidhje me draft kontratën e koncesionit me objekt “Për shërbimin e kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm”, pika II/2/a).



Procedura hetimore

Tregu i menaxhimit të faciliteteve të parkimit të Tirana International Airport

KK me vendimin nr. 921, datë 09.11.2022 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të aeroportit “Nënë Tereza” (TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT) dhe miratimin e angazhimeve si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve për ndërmarrjen STAR PARKING ALBANIA SHPK”, vendosi:

1. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes STAR PARKING ALBANIA SHPK në tregun e menaxhimit të faciliteteve të parkimit të aeroportit “Nënë Tereza” (TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT).
2. Gjobitjen e ndërmarrjes STAR PARKING ALBANIA SHPK në masën 1% të xhiros të vitit paraardhës financiar, përkatësisht në shumën 1,614,899 (një milion e gjashtëqind e katërmëdhjetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë.
3. Miratimin e angazhimeve të depozituara nga ndërmarrja STAR PARKING ALBANIA SHPK, si të detyrueshme në formën e kushteve dhe detyrimeve, si më poshtë vijon:
 - a. Ndërmarrja STAR PARKING ALBANIA SHPK të hartojë një metodologji për llogaritjen e kostove për formimin e çmimit të telepasit;
 - b. Ndërmarrja STAR PARKING ALBANIA SHPK të aplikojë tarifa të orientuara drejt kostos, për ndërmarrjet që pajisen me telepas si dhe për çdo shërbim tjetër;
 - c. Ndërmarrja STAR PARKING ALBANIA SHPK nuk do të zbatojë kushte të pabarabarta me ndërmarrjet të cilat lidhin kontratë me STAR PARKING për tu pajisur me telepas, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence.
4. Ndërmarrja STAR PARKING ALBANIA SHPK ka detyrimin të mos abuzojë me pozitën dominuese veçanërisht:
 - a. vendosjen, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, e çmimeve të padrejta të blerjes oseshitjes apo e kushteve të tjera të padrejta të tregtimit;
 - b. kufizimin e prodhimit, tregjeve ose zhvillimit teknik;
 - c. zbatimin e kushteve të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence;
 - d. vendosjen e kushteve për lidhjen e kontratave me palët e tjera, që këto të fundit të pranojnë detyrime shtesë, të cilat, për vetë natyrën e tyre ose sipas praktikave tregtare, nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë.
5. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, ndërmarrja STAR PARKING ALBANIA SHPK në zbatim të nenit 76, pika 1, germa (a) të ligjit nr. 9121/2003 ndëshkohet me penalitetin përkatës.
6. Për përmbushjen e kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi, ndërmarrja STAR PARKING ALBANIA SHPK do të monitorohet për një periudhë 1 (një) vjeçare.

Procedura hetimore

Tregun e importit të grurit, importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit

KK, nëpërmjet vendimit nr. 935, datë 16.12.2022 “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve AGRO BLEND SHPK, MIELL TIRANA SHA, BLOJA SHA dhe ATLAS MILLS SHPK për moszbatimin e detyrimeve të përcaktuar në VKK nr. 839 datë 29.9.2021” vendosi:

1. Gjobitjen e ndërmarrjes AGRO BLEND SHPK për moszbatimin e detyrimeve të sanksionuara në pikën I dhe II të VKK nr. 839/2021, në masën 5,774,395 (pesë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e treqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë.
2. Gjobitjen e ndërmarrjes BLOJA SHA për moszbatimin e detyrimeve të sanksionuara në pikën I dhe II të VKK nr. 839/2021, në masën 1,468,877 (një milion e katërqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë.
3. Gjobitjen e ndërmarrjes MIELL TIRANA SHA për moszbatimin e detyrimeve të sanksionuara në pikën I të VKK nr. 839/2021, në masën 2,025,659 (dy milion e njëzet e pesë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë.
4. Gjobitjen e ndërmarrjes ATLAS MILLS SHPK për moszbatimin e detyrimeve të sanksionuara në pikën I të VKK nr. 839/2021, në masën 1,324,390 (një milion e treqind e njëzet e katër mijë e treqind e nëntëdhjetë) lekë.



Procedura hetimore

Tregu ku ushtrojnë veprimtarinë Subjektet Financiare Jobanka

KK me vendimin nr. 906, datë 29.07.2022 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë SFJB” vendosi:

1. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun ku ushtrojnë veprimtarinë subjektet financiare jobankare (SFJB).
2. T’i rekomandojë SFJB që operojnë në treg, respektimin e dispozitave të nenit 9 të ligjit nr.9121/2003.
3. T’i rekomandojë Bankës së Shqipërisë, si organi rregullator i tregut në të cilin operojnë SFJB:
 - a. Të hartojë raporte mbikëqyrjeje të veçanta për SFJB duke përcaktuar pjesët respektive të tregut për secilin SFJB në tregun ku ajo operon, t’i publikojë dhe t’i bëjë transparente ato.
 - b. Të hartojë një rregullore të veçantë për përcaktimin dhe miratimin e rregullave për kredinë konsumatore, mikrokredinë, faktoringun, qiranë financiare për mirëfunksionimin e tregut ku operojnë SFJB.
 - c. Të bashkëpunojë me AK në rastet kur konstatohen shenja të kufizimit të konkurrencës, në kuptim të nenit 4 dhe 9 të ligjit 9121/2003.



Kontrolli i përqendrimeve

ALBTELECOM SHA / 4IG NYILVANOSAN MUKODO RESZVENYTARSASAG

KK me vendimin nr. 855, datë 14.01.2022 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së 80.27% të aksioneve të shoqërisë ALBTELECOM SHA nga shoqëria 4IG NYILVANOSAN MUKODO RESZVENYTARSASAG” vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nga përfthimi i kontrollit nëpërmjet blerjes së 80.27% të aksioneve të shoqërisë ALBTELECOM SHA nga shoqëria 4IG NYILVANOSAN MUKODO RESZVENYTARSASAG. Tregu përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i komunikimeve elektronike. Nisur nga fakti që shoqëria 4IG NYRT nuk operonte dhe nuk gjeneronte të ardhura në Shqipëri, përqendrimi nuk do të krijonte mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sillte ndryshim në pjesën e tregut që zotëron shoqëria ALBTELECOM SHA në tregun përkatës të produktit.



SCAN SHA / BALFIN - BALKAN FINANCE INVESTMENT GROUP SHPK

KK me vendimin nr. 868, datë 04.03.2022 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfthimit të kontrollit të shoqërisë SCAN SHA nga shoqëria BALFIN - BALKAN FINANCE INVESTMENT GROUP SHPK” vendosi të autorizojë përqendrimin. Tregu përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i medias audiovizive. Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje të aktivitetit të palëve në tregun horizontal ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë asnjë ndryshim të pjesës së tregut të shoqërisë target, në tregun e mediave audiovizive në Shqipëri.



ALPHA BANK ALBANIA SHA / OTP BANK NYRT

KK me vendimin nr. 871, datë 25.03.2022 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfthimit të kontrollit të shoqërisë ALPHA BANK ALBANIA SHA nga shoqëria OTP BANK NYRT” vendosi të autorizojë përqendrimin. Tregu përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i shërbimeve bankare. Ky transaksion nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.



RIOFARMA SHPK / TRIMED SHPK

KK me vendimin nr. 923, datë 21.11.2022 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfthimit të kontrollit të shoqërisë RIOFARMA SHPK nga shoqëria TRIMED SHPK” vendosi autorizimin e përqendrimit. Tregu përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i shitjes së barnave dhe tregu i shitjes së produkteve mjekësore. Shoqëria RIOFARMA SHPK nuk ka aktivitet dhe nuk është një konkurrent aktual në treg, për këtë arsye ky transaksion nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.



AK përballë proçeseve gjyqësore

Çështje të gjykuara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë

Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, përgjatë 2022 janë shqyrtuar 7 (shtatë) çështje.

- **Çështja gjyqësore me palë paditëse: ndërmarrjen SWISS APPROVAL ALBANIA SHPK**

Objekt: Konstatimin e pavlefshmërisë dhe shfuqizimin dhe/ose anulimin pjesërisht të vendimit Nr. 884 datë 18.05.2022 të Komisionit të Konkurrencës pranë Autoritetit të Konkurrencës “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes NOA CONTROL SHPK në tregun e ofrimit të shërbimit të kontrollit ligjor të instrumenteve matëse, nëpërmjet verifikimit të instrumenteve shpërndarëse të karburantit dhe gazit të lëngshëm, me detyrime për ndërmarrjen NOA CONTROL SHPK dhe rekomandime për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë” përjashtuar këtu rekomandimet e dhëna ndaj MIE.



Gjykata Administrative e Shkallës së Parë vendosi pushimin e gjykimit për shkak të heqjes dorë nga pala paditëse.

- **Çështja gjyqësore me palë paditëse: ndërmarrjen BANKERS PETROLEUM ALBANIA LTD**

Objekt: Konstatimin paligjshmërisë së vendimit Nr. 793, datë 22.04.2021 të Komisionit të Konkurrencës pranë Autoritetit të Konkurrencës “Mbi monitorimin e zbatimit të vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 702, datë 30.07.2020, nga ndërmarrja BANKERS PETROLEUM ALBANIA LTD.



Gjykata Administrative e Shkallës së Parë vendosi rrëzimin e kërkesë - padisë. Ndërmarrja BANKERS PETROLEUM ALBANIA LTD ka ushtruar të drejtën e ankimit pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

Në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, përgjatë 2022 është shqyrtuar 1 (një) çështje:

- **Çështja gjyqësore me palë paditëse: ndërmarrjen FLORFARMA SHPK**

Objekt: Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke vendosur pezullimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv për VKK Nr. 765, datë 22.01.2021 “Mbi zbatimin e VKK nr. 685, datë 18.03.2020 “Për marrjen e masës së përkohshme për vendosjen e konkurrencës në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë të materialeve paramjekësore” për ndërmarrjen FLORFARMA SHPK” të Autoritetit të Konkurrencës. Gjykata Administrative e Apelit vendosi pushimin e gjykimit për shkak të heqjes dorë nga pala paditëse.



Gjykata Administrative e Shkallës së Parë vendosi rrëzimin e kërkesë-padisë.

Të drejtat ekskluzive

Projekti i investimit strategjik “Marina & Jahtet e Durrësit” dërguar nga AIDA

KK me vendimin nr. 917, datë 24.10.2022, “Mbi disa rekomandime mbi draft Marrëveshjen Kuadër për projektin e investimit strategjik “Marina & Jahtet e Durrësit” dhe marrëveshjeve të tjera të dakortësuara ndërmjet Komitetit të Negociimit të Marrëveshjeve dhe subjektit investues, EAGLE HILLS REAL ESTATE DEVELOPMENT SHPK”, vendosi :

1. T’i rekomandojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë që:
 - a. Përpara se porti Marina & Jahtet e Durrësit të deklarohet i hapur për trafik ndërkombëtar, të miratojë metodologjinë e përcaktimit të tarifave të shërbimeve portuale të ofruara nga investitori strategjik, tarifa të cila duhet të jenë të orientuara drejt kostos.
 - b. Investitori strategjik të miratojë një rregullore mbi funksionimin e Marina & Jahtet e Durrësit ku të përcaktojë qartë:
 - mënyrën e operimit të mjeteve lundruese sipas parimit “kush hyn i pari, shërbehet i pari”;
 - të drejtën e barazisë për shoqëritë që do të kryejnë shërbime pranë këtij porti, duke vendosur kushte të barabarta për veprime tregtare të njëjta;
 - c. Investitori strategjik të miratojë programe të përputhshmërisë me ligjin nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës, për të gjitha shërbimet që do të ofrojnë në Marina & Jahtet e Durrësit.
2. T’i rekomandojë AIDA-s që brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të marrëveshjes së ndërmarrjes së përbashkët, investitori strategjik (JV), të depozitojë pranë Autoritetit të Konkurrencës, njoftimin në zbatim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, sipas parashikimeve në draft Marrëveshjen Kuadër.



Bashkëpunimi ndërkombëtar

Gjatë veprimtarisë së vitit 2022, AK ka synuar forcimin e marrëdhënieve ndërkombëtare me institucionet homologe, forumet dhe qendrat e trajnimeve të konkurrencës në rajon e më gjerë.

Stafi i AK është trajnuar në kuadër të bashkëpunimit me organizatat, si më poshtë vijon:

Qendra Rajonale e Konkurrencës (OECD-GVH/RCC)



Në kuadër të bashkëpunimit me OECD-GVH/RCC janë realizuar trajnimet në formë virtuale:

- Në datat 16 - 17 shkurt u zhvillua nga RCC nje workshop virtual me temë "Përcaktimi i tregut: metodologjitë, sfidat dhe zhvillimet" ku kanë marrë pjesë 3 përfaqësues.
- Në datën 22 mars u zhvillua nga RCC, takim virtual me kryetarët e agjensive, me temë "Rishikimi i së kaluarës për të projektuar të ardhmen; Përcaktimi i tregut: metodologjitë, sfidat dhe zhvillimet" ku ka marrë pjesë kryetari i AK.
- Në datën 7 prill, u zhvillua nga Këshilli i Konkurrencës i Bosnjë dhe Hercegovinës me mbështetjen e RCC, Konferenca virtuale "Praktikat antikonkurrese të shoqërive publike" ku kanë marrë pjesë 3 përfaqësues.

Trajnime, seminare dhe konferenca, ku pjesëmarrësit kanë qenë të pranishëm:

- Në datat 16 - 19 maj, u zhvillua nga RCC, trajnimi hyrës për stafet e reja – Parimet dhe procedurat e ligjit të konkurrencës, në Budapest, Hungari, ku ka marrë pjesë 1 përfaqësues.
- Në datat 14 - 16 qershor u zhvillua nga RCC, seminari me temë "Masat e përkohshme në çështjet e konkurrencës", në Budapest, Hungari, ku ka marrë pjesë 1 përfaqësues.
- Në datat 28 - 29 shtator u zhvillua nga RCC seminari me temë "Rregullorja ex ante dhe zbatimi i ligjit të konkurrencës në tregjet digjitale", në Zagreb, Kroaci, ku ka marrë pjesë 1 përfaqësues.
- Në datën 30 shtator, u zhvillua nga RCC në bashkëpunim me Autoritetin e Konkurrencës së Kroacisë, konferenca e 25 vjetorit të Autoritetit të Konkurrencës së Kroacisë, në Zagreb të Kroacisë, ku ka marrë pjesë 1 përfaqësues.

Aktivitete të tjera në kuadër të bashkëpunimit me ICN dhe Joint Vienna Institute, të zhvilluara virtualisht:



- Në datat 9 - 11 shkurt u zhvillua workshop i ICN-së për Advokacinë, ku kanë marrë pjesë 2 përfaqësues.
- Në datat 21 shkurt - 4 mars u zhvillua nga Joint Vienna Institute, trajnimi virtual me temë "Konkurrenshmëria, rritja dhe kriza", ku kanë marrë pjesë 2 përfaqësues.

Workshope, Trajnime:

- Në datat 29 mars - 1 prill u zhvillua workshop-i ICN-së mbi përqendrimet për vitin 2022, në Salvador, Brazil, ku kanë marrë pjesë 2 përfaqësues.
- Në datat 4 - 6 maj u zhvillua konferenca vjetore e 21-të e ICN-së, në Berlin, Gjermani, ku ka marrë pjesë 1 përfaqësues.
- Në datat 10 - 11 tetor u zhvillua nga Komisioni Evropian trajnimin me temë "Ndihma shtetërore për vendet e zgjerimit dhe fqinjësisë" në Bruksel, Belgjikë, ku ka marrë pjesë 1 përfaqësues.
- Në datat 10 - 14 tetor u zhvillua, nga Joint Vienna Institute, trajnimi me temë "Partneriteti publik-privat", në Vienë, Austri, ku ka marrë pjesë 1 përfaqësues.

Aktivitete të tjera në kuadër të bashkëpunimit me OECD, UNCTAD, BEREC, KE dhe Autoritete homologe; Konferenca, Forume



- Në datë 23 mars u zhvillua nga BEREC, Forumi i Palëve të Interesit BEREC për vitin 2022, në Bruksel, Belgjikë, ku kanë marrë pjesë 2 përfaqësues.
- Në datat 16 - 17 qershor u zhvillua Unioni European i Juristëve (EBA), edicioni i XV i Konferencës Antitrust të Treviso me temë "Ligji Antitrust ndërmjet legjislacionit të BE-së dhe legjislacionit kombëtar", në Trevizo, Itali, ku ka marrë pjesë 1 përfaqësues.
- Në datat 1 - 2 qershor u zhvillua takimi i 27-të i Forumit Vjetor të Komunitetit të Energjisë (Forum i Athinës) në Athinë, Greqi, ku ka marrë pjesë 1 përfaqësues.
- Në datë 29 qershor u zhvillua Forumi i Konkurrencës së Athinës dhe konferenca e saj ndërkombëtare, në Athinë, Greqi, ku ka marrë pjesë 1 përfaqësues.
- Në datat 20 - 22 korrik u zhvillua nga UNCTAD sesioni i 21-të i Grupit Ndërqeveritar të Ekspertëve IGE, në Gjenevë, Zvicër, ku ka marrë pjesë 1 përfaqësues.
- Në datën 4 tetor u zhvillua nga Komuniteti i Energjisë, Forumi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve: lundrimi nëpër kriza - përsheptimi i tranzicionit të energjisë, në Vienë, Austri, ku ka marrë pjesë 1 përfaqësues.
- Në datat 1 - 2 dhjetor u zhvillua nga OECD, Forumi Global i Konkurrencës, në Paris, Francë ku kanë marrë pjesë 3 përfaqësues.
- Në datat 16 - 17 nëntor nga Agjencia Kombëtare e Konkurrencës gjeorgjiane u zhvillua Konferenca Ndërkombëtare për Konkurrencën dhe Mbrojtjen e Konsumatorit, në Tbilisi, Gjeorgji, ku ka marrë pjesë 1 përfaqësues.



Integrimi Evropian



Procesi i integrimit evropian përbën një nga prioritetet e veprimtarisë së AK. Si një institucion lider dhe koordinator për kapitullin e tetë, “Politika e konkurrencës”, AK jep kontributin e tij në kuadër të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE), raporton në mënyrë periodike pranë Kryenegociatorit, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, për “Tregun e brendshëm dhe konkurrencën”, si dhe jep kontributin e tij për Progres Raportin.

Gjatë vitit 2022, AK ka hartuar Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2023 - 2025, i cili është dokumenti bazë për përcaktimin e prioritetëve, planifikimin, koordinimin dhe monitorimin e përmbushjes së detyrimeve në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. AK ka përgatitur dhe integruar në këtë plan kombëtar kapitullin 8 “Politika e konkurrencës”, duke parashikuar nismat ligjore afatshkurtra dhe afatmesme në kuadër të procesit të përafrimit të legjislacionit me atë të BE-së.

Në përputhje me Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2021 - 2023, Autoriteti i Konkurrencës ka përmbushur 100% këtë plan, duke miratuar brenda afateve kohore të përcaktuara, nismat ligjore të parashikuara, në përputhje të plotë me legjislacionin evropian në fushën e konkurrencës.

Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 890, datë 10.06.2022 miratoi “Udhëzim mbi kufizimet e konkurrencës “sipas objektit” për qëllime të përcaktimit të marrëveshjeve me rëndësi të vogël”.

Nënkomiteti “Tregu i brendshëm dhe konkurrenca ...”

Takimi i 12-të i nënkomitetit “Tregu i brendshëm dhe konkurrenca ...”, u zhvillua në 5 maj 2022 në Bruksel. AK paraqiti një raport të hollësishëm të aktivitetit të institucionit, lidhur me procesin e përafrimit të legjislacionit dhe nismat e parashikuara në të ardhmen, aktivitetet zbatuese dhe implementimin e ligjit si dhe lidhur me rritjen dhe forcimin e kapaciteteve institucionale. Përfaqësuesit e BE-së vlerësuan ndërhyrjet në treg nëpërmjet rasteve hetimore dhe vendimmarrjen e KK, rekomandimet e dhëna për institucionet qendrore e ato rregullatore, si dhe procesin e përafrimit dhe plotësimit të legjislacionit.



Kapacitete njerëzore

Për vitin 2022, AK në funksion të përmbushjes së detyrimeve në zbatim të ligjit nr. 9121/2003, ka pasur si objektiv strategjik të tij, për t'u afruar sa më shumë me modelin institucional të institucioneve homologe të vendeve të BE. Autoriteti i Konkurrencës është i organizuar nga një numër prej 46 punonjësish, sipas strukturës së miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë "Për një ndryshim në strukturën dhe organikën e AK", e cila është miratuar me vendimin e Kuvendit nr. 27/2021 "Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 43/2017 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Autoritetit të Konkurrencës".



Për sa më sipër, gjatë vitit 2022, AK i ka kërkuar Kuvendit të Shqipërisë një shtesë prej 4 (katër) inspektorësh, për shkak të shtimit të numrit të hetimeve (paraprake dhe të thelluara), monitorimeve në terren dhe nevojës për të patur ekspertë të dedikuar për integrimin në BE, për të mbuluar aktivitetin në rritje, për të gjitha tregjet në territorin e RSH, me qëllim plotësimin e nevojave të konsumatorit shqiptar, nëpërmjet një konkurrence të lirë dhe efektive si në tregjet prodhuese dhe ato të shërbimit. Rritja e numrit të punonjësve, do të sigurojë që analizat, studimet, inspektimet dhe gjithë procedurat hetimore të kryhen më shpejt.



Prioritetet 2023

①

Autoriteti i Konkurrencës, në përputhje me qëllimin e ligjit nr. 9121/2003, për një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg, do të vazhdojë monitorimet, hetimet dhe analizat në tregjet sensitive dhe me impakt të drejtpërdrejtë në mirëqenien e konsumatorit shqiptar, si:

②

- Tregu i telefonisë celulare;
- Tregu i materialeve të ndertimit (tulla, hekur, cemento, beton);
- Tregu i prokurimeve;
- Tregu i mediave audiovizive;
- Tregu i prodhimit të qumështit dhe nënproduktet e tij;

③

Autoriteti i Konkurrencës do të vlerësojë rast pas rasti sjelljen e ndërmarrjeve të cilat gëzojnë pozitë dominuese nëpërmjet marrëveshjeve koncesionare.

Përafrimi institucional me standardet dhe praktikat e BE-së

Disa nga prioritetet e PKIE 2023 - 2025 në fushën e konkurrencës janë hartimi i disa udhëzimeve për te plotësuar kuadrin ligjor dytësor:



- Autoriteti i Konkurrencës ka në fokus ndjekjen e procesit të rishikimit të ligjit 9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës". Në këtë proces, do të përfshihen institucione qendrore dhe të pavarura dhe palë të tretë të interesuara të tilla si dhomat e tregtisë, studiot ligjore, shoqatat e biznesit, të cilët do të japin kontributin e tyre, sugjerimet dhe komentet e tyre. Amendimet ligjore do të dërgohen edhe pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, si dhe pranë Shërbimit të Delegacionit Evropian përpara depozitimit në Kuvendin e Shqipërisë.



- Për vitin 2023 është parashikuar udhëzuesi "Mbi udhëzimet jozyrtare për sa i përket çështjeve të reja ose të pazgjidhura në lidhje me nenet 4 dhe 9 të ligjit nr.9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" për raste individuale, në përputhje me Njoftimi i Komisionit mbi udhëzimet jozyrtare për sa i përket çështjeve të reja ose të pazgjidhura në lidhje me nenet 101 dhe 102 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian për raste individuale (letra udhëzuese) (C (2022) 6925 final). Ky udhëzues është parashikuar për tu miratuar tremujorin e dytë të vitit 2023.

Prioritetet 2023



- Forcimi i kapaciteteve administrative, nëpërmjet trajnimit të stafit të ri dhe ekzistues me qëllim rritjen e cilësisë së monitorimit, inspektimit, hartimit të raporteve, analizave, mbrojtjes së vendimeve të KK në proceset gjyqësore, në të gjitha shkallët e gjyqësorit.



- Adresimi në mënyrë të përshtatshme dhe domethënëse të çështjeve sensitive (trajtimi i ankesave), si dhe bashkëpunimin me institucionet e administratës qendrore dhe vendore, entet dhe institucionet e tjera rregullatore për rregullimin e veprimtarisë ekonomike në territorin e RSH për të siguruar një konkurrencë efektive në treg.



- Angazhohet në rritjen e bashkëpunimit me institucionet homologe dhe ente rregullatorë, duke nënshkruar me to edhe memorandume mirëkuptimi (MOU).



European Bank
for Reconstruction and Development

- Autoriteti i Konkurrencës do të jetë përfitues i një projekti me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për asistencë teknike dhe suport për zbatimin e strategjisë së advokacisë.



Struktura organizative e AK

